

Zbatimi i masave për promovimin e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali e Egjiptianë në vitin 2018:

Raport vlerësimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 –2022

Artane Rizvanolli

Janar 2019

*Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit “Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020 të financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me Balkan Sun-floëers (BSFK), Syri i Vizionit (SiV) dhe Roma and Ashkalia Documentation Center (RADC). Përmbytja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

KEC falënderon përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, Zyrës për Qeverisje të Mirë (Zyra e Kryeministrit), dhe të organizatave të shoqërisë civile, për informatat dhe kontributin e tyre për këtë raport.

Përmbajtaj

1. Hyrje.....	3
2. Konteksti.....	4
3. Masat, aktivitetet dhe rezultatet e realizuara.....	7
3.1- Masa 1: Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës.....	7
3.2- Masa 2: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike.....	8
3.3- Masa 3: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali.....	10
3.4- Masa 4: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimin dhe MATP.....	12
3.5- Masa 5: Dizajnimi/ modifikimi i shërbimeve të punësimin dhe masave aktive të punës në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali...	13
3.6- Masa 6: Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimin dhe masat aktive të tregut të punës.....	15
3.7- Masa 7: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.....	16
4. Konkludimet dhe rekomandimet.....	17

1. Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i nivelit të arritjes së rezultateve dhe të zbatimit të aktiviteteve dhe masave të parapara në Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022 në lidhje me promovimin e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë gjatë vitit 2018.

Për këtë qëllim janë analizuar dokumentet strategjike, analizat, raportet vjetore dhe të dhënat e institucioneve relevante për vitet e fundit, me përqendrim të veçantë në ato të vitit 2018. Gjithashtu, përmes pyetësorit gjysmë të strukturuar janë intervistuar përfaqësuesit e institucioneve relevante:

- Departamenti për Punë dhe Punësim, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
- Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Qeverinë e Kosovës

Duke qenë se një pjesë e masave dhe aktiviteteve në Strategjinë Sektoriale të MPMS janë paraparë të realizohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ose nga vetë këto organizata, dhe me qëllim të marrjes së informatave të plota nga terreni, për qëllim të këtij raporti është organizuar edhe:

- Një intervistë grupore (po ashtu gjysmë e strukturuar) me përfaqësues të projekteve ose organizatave joqeveritare (OJQ) që merren kryesisht ose ekskluzivisht me çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Balkan Sunfloëers, Nevo Koncept, Syri i Vizionit, Terres des Hommes, The Ideas Partnership, Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkallike dhe Egjiptiane.

Bazuar në burimet më lart, raporti përmbledh arritjet e vitit 2018 në fushën e promovimit të punësimit të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në Kosovë, me përqendrim të veçantë tek aktivitetet, masat dhe rezultatet e parapara me Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022, e cila për këtë fushë i referohet Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021.

Raporti është i organizuar si vijon. Seksioni 2 paraqet kontekstin e kësaj analize dhe përmbledh dokumentet strategjike relevante në këtë fushë. Seksioni 3 paraqet masat, aktivitetet dhe rezultatet e parapara me Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022 (dhe Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021) dhe nivelin e përmbushjes së tyre gjatë vitit 2018. Seksioni 4 përmbledh gjetjet dhe ofron disa rekomandime për zbatimin e kësaj fushe të strategjisë gjatë viteve në vijim.

2. Konteksti

Megjithëse të dhënat zyrtare për treguesit e tregut të punës të disagreguara në nivel të komuniteteve mungojnë në Kosovë, analizat e ndryshme tregojnë se gjendja e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është shumë e rëndë, siç përmbledhet edhe në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021. Këto komunitete kanë normë më të lartë të papunësisë dhe normë më të ulët të punësimit në krahasim me shumicën shqiptare si dhe komunitetet tjera pakicë në Kosovë. Për shembull, Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2010 vlerëson se shkalla e papunësisë tek këto komunitete në vitin 2009 ishte rreth 58 për qind, në krahasim me mesataren e popullatës prej 45 për qind¹. Ndërsa, disa vite më vonë vlerësohet se në komunitatet e Obiliqit dhe Fushë Kosovës shkalla e punësimit për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët ishte vetëm 7 për qind, krahasuar me 40 për qind për shqiptarët dhe 21 për qind për serbët². Për më tepër, vendet e punës në të cilat janë të angazhuar këto komunitete janë shpesh të përkohshme, dhe përbëjnë punë fizike që nuk kërkojnë shkathtësi të larta dhe nuk paguhen mirë³, ndërsa këto komunitete janë të nën-përfaqësuara edhe në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike⁴, megjithëse ekziston një kornizë ligjore që siguron përfshirjen e tyre në punësim në sektorin publik.

Duke pasur parasysh këtë situatë, punësimi është një ndër fushat e identifikuar si fusha të rëndësishme së veçantë për integrimin e këtyre komuniteteve (bashkë me arsimin, banimin, mirëqenien sociale dhe shëndetësinë) në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 të aprovuar nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2017. Duhet theksuar se kjo Strategji fillimisht ishte dedikuar për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, mirëpo Qeveria e Kosovës e ka hequr komunitetin egjiptian nga masat e parapara në Strategji në fazën përfundimtare të aprovimit të saj, pasi ishte hartuar drafti përfundimtar i këtij dokumenti strategjik në një proces gjithëpërfshirës gjatë të cilit kanë bashkëpunuar Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në Qeverinë e Kosovës, ministritë përkatëse dhe organizata të shumta të shoqërisë civile në Kosovë të cilat merren me çështjet e këtyre komuniteteve.

1. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2010.

2. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Community Vulnerability Assessment Report, 2013.

3. Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Gjendja e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, 2010, dhe Organizata Botërore e Punës (ILO), Tranzicioni i të Rinjve në Punë të Mirë: Dëshmitë nga Kosova, Dokumenti i Politikave të Punësimit i ILO 2007/4

4. Sh.Berisha për Institutin Demokratik i Kosovës (KDI), Hulumtim Parlamentar: Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në shërbim civil, 2016, dhe Zyra e Kryeministrit/Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim i Punësimit të Pjesëtarëve të Komuniteteve jo-shumicë në Shërbim Civil dhe Ndërmarrjet Publike në Kosovë, 2013.

Megjithëse Strategjia në versionin përfundimtar të aprovuar nga Qeveria e Kosovës i referohet vetëm komuniteteve rom dhe ashkali, është inkurajuese që përkundër këtij fakti institucionet kosovare kanë vazhduar të punojnë për integrimin e këtyre tri komuniteteve pa dallim, duke e pasur parasysh se pavarësisht dallimeve eventuale në mes tyre, të tri këto komunitete përballen me sfida të njëjta në fushën e punësimit. Përfshirja e këtij komuniteti në aktivitetet e rregullta (si forume, takime të përbashkëta, etj.), si dhe në aktivitete specifike për të integruar integrimin e tyre gjatë vitit 2018 (që do të vazhdojnë në vitin 2019) konfirmohet nga ZQM. Ngjashëm, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në Strategjinë Sektoriale 2018 – 2022 të saj, si dhe në Politikën e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021 i referohet të tri këtyre komuniteteve në objektivat dhe aktivitetet e parapara për promovimin e punësimit në Kosovë.

Për fushën e punësimit Strategjia Sektoriale e MPMS 2018 – 2022 përcakton Objektivin strategjik 1, dhe pesë Objektiva specifike që detajojnë më tej këtë objektivi, njëri prej të cilëve është përmirësimi i nivelit të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (shih Kutinë 2.1). Për Objektivin specifik 1.5 që i referohet nivelit të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, Strategjia Sektoriale e MPMS 2018 – 2022 nuk parashah aktivitete specifike

Objektivi strategjik 1: Ulja e inaktivitetit, rritja e punësimit, zhvillimi i shkathtësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe administrimi më i mire i tregut të punës.

Objektivi specifik 1.1: Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve publike të punësimit

Objektivi specifik 1.2: Zgjerimi i shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve, si dhe ngritja e efikasitetit dhe cilësisë së tyre

Objektivi specifik 1.3: Ofrimi i shërbimeve cilësore të aftësisë profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës

Objektivi specifik 1.4: Rritja e punësimit të rinjve

Objektivi specifik 1.5: Përmirësohet niveli i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (aktivitetet e planifikuara në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian* në Shoqërinë Kosovare 2017-2021)

*Vini re që Strategjia Sektoriale e MPMS në kohën e hartimit të saj i referohet dokumentit të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, para se komuniteti egjiptian të hiqet nga teksti në fazën përfundimtare

shtesë, mirëpo i referohet Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021. Duke pasur parasysh mundësitë reale të politikë bërësve për të ndikuar në nivelin e punësimit të këtyre komuniteteve në kushtet e një ekonomie tregu, si dhe kornizën ligjore në fuqi, kjo e fundit parasheh masa dhe aktivitete që në vija të trasha mund të përmbliidhen si vijon:

- Nxitjen e zbatimit të kornizës ligjore që rregullon e përfaqësimin në punësim të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil në favor të punësimit të këtyre komuniteteve.
- Nxitjen e punësimit të këtyre komuniteteve në sektorin publik dhe privat përmes masave aktive të tregut të punës të realizuara nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK)⁵, përfshirë masat që nxisin punëdhënësit për të punësuar pjesëtarë të këtyre komuniteteve (si p.sh. subvencionimi i pagave) dhe ato që rrisin shkathtësitë e punëkërkuësve të këtyre komuniteteve për t'i përgatitur ata për vendet e punës në përputhje me nevojat e tregut (si p.sh. aftësimi profesional). Në kuadër të këtyre aktiviteteve përfshihet edhe informimi i këtyre komuniteteve për mundësitë që APRK ofron për të papunët, si parakusht që do të mundësonte përmirësimin e qasjes së tyre tek shërbimet dhe masat në dispozicion.

Seksioni në vijim ofron një pasqyrë më të detajuar të masave dhe aktiviteteve të parapara në këto dokumente strategjike, si dhe nivelin e zbatimit të tyre dhe përparimin në arritjen e rezultateve të parapara (aty ku të dhënat lejojnë) gjatë vitit 2018.

Duke qenë se për Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021, aktivitetet e së cilës janë bartur në Strategjinë Sektoriale të MPMS 2018 – 2022, ekziston një Kornizë për vlerësim e përkrahur nga projekti i financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN”⁶, edhe kjo kornizë është marrë parasysh përgjatë realizimit të këtij vlerësimi. Gjithashtu, duhet theksuar se përkundër faktit që Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 i referohet vetëm komuniteteve rom dhe ashkali, gjatë këtij vlerësimi do të raportohen statistikat dhe aktivitetet për të tri komunitetet (rom, ashkali dhe egjiptian) për dy arsye: (i) për të reflektuar në mënyrë më të plotë aktivitetet e institucioneve, të cilat, siç u shpjegua më lartë, vazhdojnë të angazhohen për përmirësimin e gjendjes së të tri këtyre komuniteteve dhe, (ii) për arsyen praktike dhe teknike që në kohën e hartimit të Strategjisë statistikat për vitin bazë (p.sh. pjesëmarrja e këtyre komuniteteve në masa aktive të tregut të punës) janë përllogaritur duke pasur parasysh të tri komunitetet, prandaj çdo ndryshim metodologjik në këtë fazë do ta bënte të pakuptimtë krahasimin në mes shifrave aktuale dhe atyre bazë.

5. Vini re që Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 i referohet këtyre si “masa të realizuara nga MPMS”, meqë kjo ka qenë praktika deri në themelimin dhe funksionalizimin e APRK e cila tani është përgjegjëse për zbatimin e masave aktive të tregut të punës, përderisa MPMS e ka rolin e politikëbërjes në fushën e promovimit të punësimit.

6. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN), Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021: Korniza e monitorimit, 2017.

3. Masat, aktivitetet dhe rezultatet e realizuara

3.1 Masa 1: Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës

Masa e parë e paraparë në Strategji në fushën e punësimit është “hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe mbi përfitimin e tyre nga shërbimet/masat e ofruara nga MPMS”⁷.

Në kuadër të kësaj mase parashihet analizimi i mundësive për shfrytëzimin e të dhënave ekzistuese, me përqendrim të veçantë në burimet periodike të të dhënave si Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) dhe Sistemi i Informatave të Tregut të Punës (SIMP) i APRK, që do të mundësonin monitorimin e gjendjes së tregut të punës të këtyre komuniteteve. Informatat që do të duhej të përfshijnë: nivelin/shkallën e punësimit të këtyre komuniteteve në përgjithësi dhe sipas sektorëve/karakteristikave të punës (punë e rregullt ose e përkohshme, punë formale ose joformale, aktiviteti ekonomik, sektori publik/privat); dhe treguesit tjerë bazikë të tregut të punës (shkalla e papunësisë, shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës). Gjatë hulumtimit nuk është gjetur ndonjë statistikë ose raport që dëshmon se ky aktivitet është realizuar. Gjithashtu, në bazë të intervistave me institucionet dhe OJQ-të që merren me çështje të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian nuk është identifikuar ndonjë hap konkret për ta realizuar këtë aktivitet. Duhet theksuar se gjatë hulumtimit janë identifikuar disa raporte të publikuara në vitin 2018 që trajtojnë gjendjen në tregun e punës të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian: (i) Organizata Botërore e Punës (ILO) ka publikuar një hulumtim të perspektivës dhe përvojave të të rinjve të këtyre komuniteteve në tri komuna (Gjakovë, Fushë Kosovë dhe Graçanicë), duke u përqendruar në sfidat dhe mundësitë për të gjetur punë të denjë⁸; dhe (ii) OJQ Nevo Koncept ka publikuar një analizë të gjendjes së punëtorëve të këtyre komuniteteve në komunën e Prizrenit⁹. Mirëpo, me gjithë informatat relevante që përmbajnë, këto analiza nuk përbëjnë përparim në kontekst të këtij aktiviteti të Strategjisë meqë nuk ofrojnë të dhëna në nivel vendi dhe statistika standarde të tregut të punës si shkalla e punësimit, shkalla e papunësisë, etj.

Gjithashtu në kuadër të Masës 1 parashihet që statistikat e rregullta që mblidhen me anë të SIMP të APRK-së, si numri dhe përqindja e punëkërkesve të regjistruar, punëkërkesve për të cilët është ndërmjetësuar punësimi, pjesëmarrësve në trajnime profesionale dhe masa tjera aktive të tregut të punës, të raportohen veç e veç për secilin nga këto komunitete. Ky aktivitet është realizuar, siç dëshmohet nga raporti vjetor Puna dhe punësimi i APRK-së për vitin 2017¹⁰ i cili për herë të parë i raporton të gjitha statistikat nga SIMP për të tri komunitete veç e veç¹¹.

⁷ Vini re që në kontekstin e ri institucional, kjo masë duhet t'i referohet masave të ofruara nga APRK.

⁸ Organizata Botërore e Punës (ILO), Promovimi i mundësive për punë të denjë për të rinjtë romë, ashkali e egjiptian në Kosovë, 2018.

⁹ Nevo Koncept, Analiza e gjendjes aktuale të punëtorëve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Prizrenit, 2

¹⁰ Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), Puna dhe punësimi: Raport vjetor 2017, 2018.

¹¹ Raporti vjetor për vitin 2017 nuk është publik, mirëpo ai është siguruar nga APRK për qëllim të këtij hulumtimi.

Masa 1: Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe mbi përfitimin e tyre nga shërbimet/masat e ofruara nga MPMS.

Aktiviteti 1.1: Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor të punësimit dhe karakteristikave të punës për këto dy komunitete nga të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore.

Aktiviteti 2.1: Raportimi i rregullt i të dhënave mbi përfitimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nga shërbimet dhe masat e ofruara nga MPMS

Ky aktivitet është realizuar gjatë vitit 2018.

Kutia 3.1: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 1

3.2 Masa 2: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike

Që nga viti 2010, Ligji 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcakton përfaqësimin në shërbimin civil për komunitetet jo shumice përmes kuotës minimale prej 10 për qind në nivel qendror dhe përfaqësimit proporcional me përbërjen demografike në nivel komunal. Kjo masë parasheh monitorim dhe raportimi të rregullt mbi zbatimin e kornizës ligjore ekzistues, me fokus të veçantë në përfaqësimin në përputhje me përbërjen e popullatës në nivel komunal; por edhe në nivel qendror, megjithëse nuk ka kuota për specifike për komunitetet veç e veç. Në rast të ngecjeve në zbatim të kornizës ligjore, masa parasheh duhen hulumtuar shkaqet dhe duhet marrë masa sipas nevojës. Duke pasur parasysh natyrën e këtyre aktiviteteve, ishte paraparë që këto aktivitete të zhvillohen nga OJQ-të, me mbështetje të donatorëve. Gjatë hulumtimit nuk janë identifikuar analiza të reja për këtë çështje që nga aprovimi i Strategjisë (e fundit është analiza e KDI në vitin 2016¹²) apo aktivitete (tryeza, etj.) që synojnë vetëdijësimin e institucioneve dhe publikut dhe avokimin për përfshirje më të madhe të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në punësim në sektorin publik. Megjithatë, duhet theksuar se ZQM në raportin e saj vjetor për zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 për vitin 2017 e ka raportuar gjendjen e punësimit të këtyre komuniteteve në ministri dhe institucione të tjera në nivelin qendror¹³.

12. Sh.Berisha për Institutin Demokratik i Kosovës (KDI), Hulumtim Parlamentar: Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në shërbim civil, 2016.

13. Zyra për Qeverisje të mirë (ZQM), Raporti i Parë mbi Zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, 2017 – 2021 për vitin 2017, 2018.

Masa gjithashtu parasheh targetim specifik të këtyre komuniteteve në angazhimin si këshilltarë të punësimit (të pasuar nga trajnimi i këtyre këshilltarëve), gjë që do të ndihmonte në forcimin e qasjes së institucioneve ndaj këtyre komuniteteve dhe forcimin e besimit të këtyre ndaj institucioneve. Kjo nuk është realizuar as gjatë vitit 2018 dhe APRK ka shprehur qëndrimin se targetimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nuk mund të realizohet për shkak se në konkurse publike procedurat e rekrutimit janë të rregulluara me ligj dhe nuk lejojnë kusht të tillë në konkurs.

Masa 1: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike.

Aktiviteti 2.1: Monitorimi i situatës së punësimit në institucione publike në komnatat me pjesëmarrje më të lartë të këtyre komuniteteve.
Ky aktivitet nuk është realizuar gjatë vitit 2018.

Aktiviteti 2.2: Monitorimi i situatës së punësimit në institucione publike në nivel qendror
Ky aktivitet, siç është paraparë në Strategji, nuk është realizuar gjatë vitit 2018, megjithëse ZQM në raportin e saj vjetor për zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021 për vitin 2017 e ka raportuar gjendjen e punësimit të këtyre komuniteteve në ministri dhe institucione të tjera në nivelin qendror.

Aktiviteti 2.3: Informimi dhe avokimi, bazuar në rezultatet e hulumtimeve.
Ky aktivitet pason aktivitetet paraprake 2.1 dhe 2.2, prandaj nënkuptohet që nuk ka mundur të realizohet.

Aktiviteti 2.4: Punësimi i këshilltarëve të punësimit nga këto komunitete komnatat me numër më të madh të punëkërkesve të këtyre komuniteteve
Ky aktivitet nuk është realizuar gjatë vitit 2018 dhe janë ngritur dyshime nëse formë e tillë e rekrutimit në baza etnike fare e mundshme brenda kornizës ligjore në fuqi.

Aktiviteti 2.5: Trajnimi i këshilltarëve të punësimit të angazhuar
Ky aktivitet pason aktivitetin paraprak 2.4, prandaj nënkuptohet që nuk ka mundur të realizohet.

Kutia 3.2: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 2

3.3 Masa 3: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali

Masa 3 parasheh analizë të masave afirmative potenciale (përfshirë praktikën ndërkombëtare në këtë fushë) që do të mund të përdoren për punësimin e komuniteteve rom, dhe ashkali për bizneset dhe organizatat jofitimprurëse. Hulumtimi do të fokusohet veçanërisht në realizueshmërinë e këtyre dhe realizimin në mënyrë të drejtë (p.sh. definimi i masës; kriteret për përfitim; procedurat e vlerësimit të kriterëve, përfshirë verifikimin e etnisë së të punësuarit). Megjithatë gjatë vitit 2018 ka pasur një raport që ndër të tjera ka analizuar praktikën ndërkombëtare për promovimin e punësimit të komunitetit rom në vendet tjera të Evropës nga Qendra Kosovare për Arsim (KEC), i cili kontribuon pjesërisht në realizimin e kësaj mase, ky aktivitet nuk është realizuar siç ka qenë e paraparë.

Masa gjithashtu parasheh që kuotat si masë e aksionit afirmativ të vazhdojnë të përdoren për skemat e masave aktive të tregut të punës dhe për trajnimet profesionale, dhe që këto të përcaktohen për këto komunitete në mënyrë specifike. Gjatë vitit 2018 nuk janë vendosur kuota për pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve, mirëpo është shënuar përparim duke e trajtuar çështjen e punësimit të pjesëtarëve të këtyre në dokumentin kryesor politikë bërës në fushën e promovimit të punësimit nga MPMS, Politikën e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021. Megjithatë nuk parasheh kuota për skemat specifike, ky dokument reflekton aktivitetet e parapara me Strategjinë për promovimin e punësimit të këtyre komuniteteve dhe përcakton targete për APRK-në për përfshirje të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në masa aktive të tregut të punës, përfshirë në aftësim profesional të ofruar në Qendrat për Aftësim Profesional, si vijon: Megjithatë Politika e Punësimit parasheh dyfishim të pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve rom,

Tabela 3.1: Targetet për përfshirje të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian

Treguesi	Situata fillestare		Targetet	
	2017	2019	2020	2021
% e personave nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian përfitues të masave aktive të tregut të punës	3%	4%	5%	6%
% e personave nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian që ndërmerret në punësim	3.4%	4%	5%	6%

Burimi: MPMS, Politika e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021

ashkali e egjiptian, duhet theksuar se baza (situata fillestare) për vitin 2017 që përdoret në këtë dokument është shumë më e ulët sesa ajo e vitit paraprak (6 për qind) që përdoret në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021, së cilës i referohet Strategjia Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022. Rrjedhimisht, edhe targeti për vitin 2021 prej 6 për qindësh të shumë më i ulët sesa ai prej 10për qind i vendosur me Strategji për të njëjtin vit. Gjithashtu duhet theksuar se gjatë vitit 2018 kjo pjesëmarrje ka qenë vetëm 2.6 për qind.

Masa 3: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali

Aktiviteti 3.1: Hulumtim i masave të aksionit afirmativ që kanë funksionuar në vendet tjera Megjithëse gjatë vitit 2018 ka pasur një raport që ndër të tjera ka analizuar praktikat ndërkombëtare për promovimin e punësimit të komunitetit rom në vendet tjera të Evropës nga Qendra Kosovare për Arsim (KEC), i cili kontribuon pjesërisht në realizimin e kësaj mase, ky aktivitet nuk është realizuar siç ka qenë e paraparë.

Aktiviteti 3.2: Zbatimi i kuotave në masa aktive të tregut të punës (përfshirë trajnime profesionale) Megjithëse kuotat nuk janë zbatuar gjatë vitit 2018, dokumenti kryesor politikë bërës në fushën e promovimit të punësimit nga MPMS, Politika e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021, ka vënë targete vjetore për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian. Megjithatë, këto targete nuk janë në përputhje me Strategjinë, duke synuar përfshirje prej 6 për qind në vitin 2021, përderisa Strategjia parasheh përfshirje prej 10 për qind. Gjatë vitit 2018 pjesëmarrja ka qenë vetëm 2.6 për qind.

Kutia 3.2: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 3

3.4 Masa 4: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP

Masa 4 parasheh vlerësimin e nevojave dhe sfidave specifike të komuniteteve rom dhe ashkali, dhe vlerësimin e efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP (përfshirë trajnimin profesional) të realizuara në të kaluarën; këto do të përbënin bazën e dizajnit ose modifikimit të shërbimeve dhe MATP në përputhje me nevojat specifike të këtyre komuniteteve. Analizë do të përfshinte perceptimet e këtyre komuniteteve dhe vlerësimin e tyre për qasjen dhe efektivitetin e këtyre shërbimeve/masave, si dhe matës objektivë të efektivitetit të tyre siç janë statusi i punësimit i përfituesve dhe qëndrueshmëria e punësimit. Gjatë vitit 2018 janë identifikuar disa raporte që pjesërisht e adresojnë këtë aktivitet, më saktësisht çështjen e identifikimit të nevojave dhe sfidave specifike të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian sa i përket punësimit (dy raporte të publikuara nga KEC dhe një nga ILO), si dhe perceptimeve të tyre për qasjen në shërbime/masa të promovimit të punësimit dhe efektivitetin e tyre. Mirëpo, raportet ekzistuese shtojnë pak vlerë në kuptim të matjes së efektivitetit të shërbimeve dhe masave përmes një metodologjie rigoroze dhe matëve objektivë siç janë statusi i punësimit i përfituesve pas përfitimit të shërbimit/masës, qëndrueshmëria e punësimit, efekti në të ardhura, cilësia e vendit të punës, etj. APRK për herë të parë ka ndërmarrë hapa për të hulumtuar efektin e masave aktive (përfshirë trajnimin profesional) që i ofron për të gjithë përfituesit, dhe do të tentohet që kjo të bëhet në nivel të komuniteteve të ndryshme nëse të dhënat e lejojnë këtë. Masa 5 parasheh që në bazë të gjetjeve të vlerësimit të nevojave dhe efektivitetit të shërbimeve dhe masat aktive

Masa 4: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe masa aktive të tregut të punës

Aktiviteti 4.1: Hartimi i analizës së nevojave dhe efektivitetit të shërbimeve/masave aktive të tregut të punës për këto dy komunitete

Disa hulumtime (nga KEC dhe ILO) të vitit 2018 kanë kontribuar në realizimin e pjesërishtëm të këtij aktiviteti duke hulumtuar nevojat, sfidat dhe perceptimet e pjesëtarëve të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, mirëpo studim (rigoroz) të efektivitetit të masave dhe shërbimeve nuk është realizuar.

Kutia 3.4: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 4

3.5 Masa 5: Dizajnimi/ modifikimi i shërbimeve të punësimit dhe masave aktive të punës në përpunje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali

të tregut e punës të realizuar më herët, të dizajnohen/modifikohen shërbimet dhe masat aktive ose në rast nevojë të ofrohen shërbime shtesë (p.sh. kurse të gjuhës ose mbulimi i kostos së transportit) në mënyrë që të sigurohet përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali. Kjo do të bëhet me pjesëmarrjen aktive të OJQ-ve të komuniteteve rom dhe ashkali, dhe masat do të ishin të llojllojshme, duke përfshirë, në mes tjerash, trajnimin dhe punën praktike (të subvencionuara) në sektorin privat; subvencionimin e pagës për një kohë të caktuar; masa për zhvillimin e vetë-punësimit, përfshirë edhe grandet për fillimin e biznesit.

Megjithëse shërbime ose masa të reja nuk janë dizajnuar specifikisht për pjesëtarët e këtyre komuniteteve, APRK ka vazhduar të ofrojë masa aktive të tregut të punës për këto komunitete. Gjatë vitit 2018 nga masat aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK kanë përfituar 48 pjesëtarë të komunitetit rom, 115 të komunitetit Ashkali dhe 60 të atij egjiptian, që në total nuk e arrijnë shifrën prej 300 përfitues në vit të paraparë në Strategji (shih Tabelën 3.2). Mirëpo, numri i përfituesve të grandeve për fillim të biznesit nga këto komuniteteve ka qenë 4 herë më i lartë se që është paraparë (40 në krahasim me 10); kjo së paku pjesërisht reflekton fokusin e institucioneve dhe donatorëve në përkrahjen e të riatdhesuarve nga vendet e Evropës përmes grandeve të vetëpunësimit, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve i përkasin këtyre tri komuniteteve.

Sa i përket përfitimit të këtyre komuniteteve nga shërbimi i ndërmjetësimit në punësim të rregullt, gjatë vitit 2018 kemi një rritje në krahasim me vitin paraprak për 11%; në vitin 2018 janë ndërmjetësuar në punësim 112 pjesëtarë të këtyre komuniteteve (38 rom, 40 ashkali, 44 egjiptian), në krahasim me 110 në vitin para-

Tabela 3.2: Përfituesit e masave aktive të tregut të punës nga APRK

Masa aktive e tregut të punës	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total
Aftësim profesional në QAP	26	60	38	124
Vetëpunësim	7	19	14	40
Trajnim në punë	9	14	2	25
Praktikë profesionale	3	10	2	15
Subvencionim i pagës	2	8	4	14
Punë publike	1	4	0	5
Total	48	115	60	223

prak. Gjatë vitit 2018 gjithashtu ka pasur rritje të dukshme në pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në numrin total të ndërmjetësimeve në punësim të rregullt, duke arritur 3.8 për qind, në krahasim me 2.9 për qind në vitin 2017. Masa 6 parasheh organizim të fushatave informuese të dizajnuara në mënyrë të tillë që të sigurohet qasja tek komunitetet rom dhe ashkali, duke pasur parasysh mediat dhe mënyrat e komunikimit që shfrytëzohen nga këto komunitete; fushatat do të përfshinin edhe vizita të këshilltarëve të punësimit

Kutia 3.5: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 5

Masa 5: Dizajnimi/ modifikimi i shërbimeve (shitesë) të punësimit dhe masave aktive të tregut të punës, përfshirë trajnimet profesionale, në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali

Aktiviteti 5.1: Gjatë vitit 2018 nuk janë dizajnuar (ose modifikuar) masa aktive të tregut të punës/ shërbimeve të punësimit specifikisht për të plotësuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian.

Aktiviteti 5.2: Ofrimi i:

a) masave aktive të tregut të punës (300 përfitues në vit); Grandeve për fillim të biznesit (10 në vit) Megjithëse nuk ka shërbime ose masa specifike për pjesëtarët e këtyre komuniteteve, APRK ka vazhduar të ofrojë masa aktive të tregut të punës për këto komunitete. Gjatë vitit 2018 nga masat aktive të punës kanë përfituar gjithsej 223 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

b) Grandeve për fillim të biznesit (10 në vit)

Gjatë vitit 2018 janë dhënë 40 grande për fillim të biznesit për pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

3.6 Masa 6: Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës

në terren. Fushatat do të shfrytëzonin kapacitetet ekzistuese dhe qasjen te komunitetet të qendrave për mësim-nxënie dhe OJQ-ve të këtyre komuniteteve. Gjatë hulumtimit janë identifikuar raste të aktiviteteve të tilla me iniciativë të organizatave të shoqërisë civile në disa komuna (p.sh. në Rahovec, Prizren dhe Mitrovicë). Mirëpo, në nivel të APRK-së, që është organizatë e re e cila është përballur me sfida të tranzicionit institucional, nuk ka pasur fushata informimi. APRK në këtë fazë është e angazhuar për të marrë informata mbi nivelin e informimit dhe perceptimet e të gjithë qytetarëve për shërbimet e ofruara për APRK (përmes anketave), pas të cilës planifikohen fushata informuese gjithëpërfshirëse, d.m.th. që targetojnë të gjithë të papunët dhe punëkërkuarit, duke përfshirë edhe komunitetet pakicë.

Nëse numri i të papunëve të regjistruar merret si indikacion për nivelin e informimit për shërbimet dhe masat aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK, nuk shohim ndonjë dallim (të dukshëm) gjatë vitit 2018. Gjatë këtij viti numri i të papunëve të regjistruar nga këto tri komunitete ka qenë 5225 (1751 rom, 2637 ashkali,

837 egjiptas), që në total përbënin 5.5% të të papunëve të regjistruar. Gjatë vitit 2017 kjo shifër ishte 5155 (1784 rom, 2641 ashkali, 720 egjiptian), ndërsa pjesëmarrja në numrin total të të papunëve të regjistruar ishte e njëjtë.

Masa 6: Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës, përfshirë trajnimet profesionale

Aktiviteti 6.1: Organizimi i fushatës së informimit me pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali Gjatë vitit 2018 ka pasur raste të aktiviteteve të tilla me iniciativë të organizatave të shoqërisë civile në disa komuna (p.sh. në Rahovec, Prizren dhe Mitrovicë), mirëpo fushata apo aktivitete promovuese sistematike ana e APRK nuk ka pasur ende, as të targetuara as në përgjithësi.

Kutia 3.6: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 6

3.7 Masa 7: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali

Masa 7 parasheh promovimin e rasteve e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali që kanë arritur sukses në punësim ose vetëpunësim/biznes, me fokus të veçantë tek gratë. APRK Gjatë hulumtimit nuk janë identifikuar aktivitete të tilla.

Masa 7: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali

Aktiviteti 7.1: Emetimi i videove promovuese Ky aktivitet nuk është realizuar gjatë vitit 2018.

Kutia 3.7: Përmbledhje e gjetjeve për Masën 7

4. Konkludimet dhe rekomandimet

Ky raport ka vlerësuar nivelin e zbatimit të masave, aktiviteteve, dhe rezultateve (ku kanë lejuar të dhënat) të dedikuara për përmirësimin e punësimit e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në bazë të Strategjisë Sektoriale të MPMS 2018 – 2022 e cila për këtë çështje i referohet Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021.

Hulumtimi është bazuar në hulumtim dhe rishikim të dokumenteve strategjike, analizave, të dhënave dhe dokumenteve të tjera relevante në këtë fushë të publikuara gjatë vitit 2018, si dhe intervistave gjysmë të strukturuar (individuale e grupe) me institucionet relevante dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me çështjet e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian.

Gjatë vitit 2018 është shënuar përparim në disa aktivitete të kësaj Strategjie, megjithëse disa janë zbatuar vetëm pjesërisht:

- Për herë të parë në raportin vjetor të APRK-së Puna dhe Punësimi për vitin 2017 ka filluar raportimi i statistikave nga SIMP për këto të tri komunitete veç e veç, gjë që mundëson monitorimin e gjendjes për tregues si numri dhe përqindja e punëkërkuesve të regjistruar, punëkërkuesve për të cilët është ndërmjetësuar punësimi, pjesëmarrësve në trajnime profesionale dhe masa tjera aktive të tregut të punës, etj.
- Ka pasur disa hulumtime të organizatave të ndryshme (p.sh. KEC, ILO, Nevo Koncept) të cilat kanë hulumtuar sfidat, nevojat dhe perspektivën e punësimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, të cilat mund të ndihmojnë për të dizajnuar shërbime dhe masa për promovimin e punësimit që janë në përputhje me nevojat specifike të këtyre komuniteteve. Megjithatë, nuk janë bërë hulumtime të efektivitetit të shërbimeve dhe masave aktive të tregut të punës të realizuara për këto komunitete në të kaluarën, që do të ishte po aq e rëndësishme për të informuar dizajnimin/modifikimin e tyre në të ardhmen. Rekomandohet që tani që APRK ka përvojë me disa hulumtime të ngjashme, këto analiza të bëhen edhe specifikisht për anëtarët e këtyre komuniteteve.
- Megjithëse nuk janë zbatuar kuota për pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në masa aktive të tregut të punës gjatë vitit 2018, çështja e punësimit të këtyre komuniteteve është trajtuar gjerësisht në dokumenti kryesor politikë bërës në fushën e promovimit të punësimit nga MPMS, Politika e Punësimit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës 2019 – 2021. Ky dokument ka vënë targete vjetore për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali e egjiptianë në masa aktive të tregut të punës të ofruara nga APRK në vitet në vijim. Mirëpo, duhet theksuar se këto targete janë më të ulta sesa ato të parapara në Strategji, duke synuar përfshirje prej 6 për qind në vitin 2021, përderisa Strategjia parasheh përfshirje prej 10 për qind. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 pjesëmarrja ka qenë vetëm 2.6 për qind. Meqë këto targete janë minimumi që duhet arritur, rekomandohet që të bëhen përpjekje që këto targete të tejkalohen.

- Me iniciativë të organizatave të shoqërisë civile, gjatë vitit 2018 janë organizuar disa aktivitetet me qëllim të informimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian në disa komuna, megjithëse nuk ka pasur fushatë informimi të organizuar nga APRK, e cila është një organizatë e re e cila tani është në fazën e hulumtimit të opinionit, pas të cilës planifikohet të ketë fushata gjithëpërfshirëse (për të gjithë punëkërkesit potencialë). Rekomandohet që fushata e APRK-së në vitet e ardhshme të përfshijë edhe aktivitete, kanale informimi dhe materiale promovimi të përshtatshme për të arritur qasje tek këto komunitete.
- Megjithëse nuk janë dizajnuar shërbime ose masa që janë në përputhje me nevojat e këtyre komuniteteve specifikisht, këto komunitete kanë marrë pjesë në masa aktive të tregut të punës të rregullta të ofruara nga APRK. Gjatë vitit 2018 ka pasur 223 pjesëmarrës të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, në krahasim me 300 pjesëmarrës sa ishin paraparë. Mirëpo, norma e paraparë prej 10 përfituesve të grandeve për fillim biznesi është tejkaluar shumëfish, duke arritur 40 përfitues. Nga ana tjetër, në disa aktivitete tjera nuk është arritur përparim:
- Nuk janë bërë përpjekje për të përlogaritur statistikat standarde të tregut të punës në bazë të AFP-së ose burimeve të tjera të dhënave.
- Nga shoqëria civile nuk është monitoruar dhe raportuar situata e përfaqësimit të këtyre komuniteteve në punësim në sektorin publik dhe niveli i respektimit të kornizës ligjore në fuqi në këtë fushë, që do të rriste informimin, avokimin dhe presionin publik tek sektori publik për të përmirësuar gjendjen.
- Nuk janë angazhuar këshilltarë punësimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo çështje duhet trajtuar edhe një herë nga aspekti ligjor për të parë se nëse, dhe si, kjo do të mund të bëhej brenda kornizës ligjore në fuqi.
- Nuk janë dizajnuar masa aktive të tregut të punës që reflektojnë sfidat specifike të këtyre komuniteteve.
- Nuk janë promovuar rastet e suksesit në treg të punës të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Rekomandohet që kjo të bëhet në kuadër të fushatës gjithëpërfshirëse informuese të APRK-së në vitet në vijim.



**Zbatimi i masave për promovimin e punësimit
të pjesëtarëve të komuniteteve
Rom, Ashkali e Egjiptianë në vitin 2018:**

**Raport vlerësimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë
së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 –2022**